

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim
Me emrin e Allahut, Mëshiruesit të përgjithshëm, Mëshirbërësit

I nderuar imam, kryetar dhe kryesi, si dhe të nderuar anëtarë të xhamisë „Hëna e Re“ në Kreuzlingen.

I nderuari kryetar i komunës së qytetit Kreuzlingen, zotëri Niederberger, dhe të nderuar përfaqësues të institucioneve politike, arsimore dhe fetare në këtë qytet.

I nderuari kryetar i KMSHZ-së, Mehas efendi Alija.

Të respektuar hoxxhallarë, kryesi dhe përfaqësues të xhamive nga Zvicra dhe nga vendet e tjera!

Të nderuar përfaqësues të Bashkësive fetare Islame nga vendlindja. Të nderuar të pranishëm në këtë manifestim, vëllezër dhe motra, zonja dhe zotërinj, ju përshëndes me përshëndetjen e paqes, es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berakatuhu – Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju!

Të respektuar të pranishëm, jam i nderuar që në jubileun e 30-të të Xhamisë „Hëna e Re“, ta përfaqësoj Federatën e Organizatave Islame në Zvicër (FIDS). Kam kënaqësi që t’jua përcjell fjalët më të bukura dhe selamet më të ngrohta të kryetarit Montasar ben Mrad, të kryesisë dhe organizatave anëtare të FIDS-it, duke ju uruar për këtë pervjetor të 30 të xhamisë suaj.

Të nderuar anëtarë të xhamisë „Hëna e Re“!

Më lejoni të ju uroj për 30 vjetorin e xhamisë, që flet për angazhimin tuaj frytdhënës në themelimin dhe zhvillimin e xhamisë suaj, me çka nuk kontribuoni vetëm për komunitetin musliman shqiptar dhe xhematin tuaj, por edhe për këtë qytet dhe shoqëri.

Themelimi i xhamive ne Perëndim, nga ana e mërgatës shqiptare muslimane, flet për pjekurinë e popullit tonë në mërgatë që të ndjek rrugë institucionale dhe të ndërtoj institucione, pasi xhamia është simbol i institucionit. Bile faltarja është institucion i parë në botë me dëshminë e Kuranit. Në Kuran qendron:

إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ

„Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Meke), e dobishme udhërfyese për mbarë njerëzimin.“ [Ali Imran: 96].

Xhamia në përgjithësi ka rol multidimensional, ndërkaq në rend të parë ka rol edukativ dhe human. Nëse pyesim se çka bëheg në xhami, me pak fjalë do të thonim se në xhami gatuhet njeriu, edukohet njeriu si qenie që të jetë njeri në kuptimin e plotë të fjalës, kalitet me vlerat më madhështore njerëzore. Xhamitë janë ndërtuar për njeriun, që të edukohet, mësohet dhe të humanizohet. Ndërkaq në Perëndim, në veçanti, identifikojmë tre role të theksuara të xhamisë: Rolin fetar, kombëtar dhe integrues.

Nga xhamia, çdo herë është përçar mesazhi i mirëkuptimit, tolerancës, harmonisë në shoqëri, njohjes reciproke dhe kontributit e bashkëpunimit me të gjithë, për atë që është produktive, konstruktive dhe pozitive. Ky është edhe mesazhi i vetë Kur'anit. Allahu i

Madhërishëm ka thënë: „O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (të këqijat) e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.“ [El Huxhurat: 13].

„Ndhimohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi...“ [El Maide: 2].

Mërgata muslimane në përgjithësi, dhe ajo muslimane shqiptare në veçanti, pikërisht e frymëzuar nga mesazhi kuranor i njohjes mes popujve dhe kulturave, respektimit të tjetrit dhe komunikimit me të gjitha palët, dialogut dhe bashkëpunimit, është integruar në shoqëritë ku jeton dhe vepron, pa komplekse, natyrshëm, pa krijuar probleme, por edhe pa abuzuar me identitetin e vet.

Xhamia çdo herë ka patur rol të dëshmuar në civilizim dhe në ndërtimin e kohezionit shoqëror, kultivimin e mirëkuptimit dhe tolerancës në shoqëritë multikulturore dhe në integrimin e komuniteteve në shoqëri.

Xhamia e ushtron dhe demonstroi në shoqëri jetën kolektive të ndërtuar në harmoni, mirëkuptim dhe komunikim përmes shembullit të xhematit.

Të nderuar anëtarë të xhamisë „Hëna e Re“ në Kreuzlingen, dhe gjithë ju auditorium i nderuar, jubileumet e xhamive, aq sa e gezojnë xhematin, po aq e gëzojnë edhe FIDS-in, dhe etablimi i një xhamie, e bën krenar dhe me shpresë edhe vet FIDS-in, pasi ajo lindi në gjirin e xhamive.

Për atë, FIDS-i apelon të ndihmoheh këto fortesa të botes shpirtërore, të kulturës, civilizimit dhe kalitjes së vlerave.

Kush ndihmon në konstituimin e një xhamie, i ka bërë vetes një pallat në kopshtet e xhenetit në botën tjetër. Këtë na e ka thënë vetë Pejgamberi as. Për atë, të shpejtojmë ti bëjmë vetes vend në xhenet, duke u bërë pjesë e ndihmimit financiar të xhamive.

E lusim të Madhin Zot që të i shpërblejë të gjithë ata që kanë kontribuar dhe që kontribuojnë në mirëmbajtjen e xhamisë „Hëna e Re“ dhe të çdo xhamie tjetër.

Zoti na ndihmoftë t'i arrijmë synimet tona fisnike, si në shoqëritë ku veprojmë në mërgatë, e ashtu edhe në vendin tonë amë!

Festofshi edhe shumë jubileume tjera. Ju faleminderit, ve selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu.

Dr. Bashkim Aliu,

anëtar i kryesisë qëndrore të Federatës së Organizatave Islame në Zvicër.